

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"ALISSA COSTRUZIONI" SH. P. K.

Sot, më datë 24. 12. 2004 (dymijë e katër), unë i nënshkruari :

Artan DULAKU, i datëlindjes 30. 05. 1965, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në adresën : Rruga "Pjetër Bogdani", Nr. 24/4, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i Pasaportës me Nr.Z. 0031648, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar

në përputhje me Ligjin Nr. 7638, datë 14.12.1992, "Për Shoqëritë Tregfare", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar "ALISSA COSTRUZIONI" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria"), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi.

Neni 1

Emri i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar është "ALISSA COSTRUZIONI" Sh.p.k..

Neni 2

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën : Rruga e " Perlat Rexhepi", Zyra Nr. 6, në katin II, të Godinës me 2+13 Kate, Tiranë. Shqipëri. Shoqëria ka të drejtë të çelë degë, filiale, apo zyra përfaqësimi, brenda dhe jashtë vendit në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe të vendit ku është hapur.

Neni 3

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë e pakufizuar mbi 10 vjet, duke filluar që prej datës së regjistrimit të saj në Rregjistrin e Shoqërive Tregtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Tiranë.

Neni 4

Objekti i Shoqërisë është si vijon :

- Prodhimi dhe tregëtimi me shumicë dhe pakicë i materialeve të ndërtimit, import eksport i tyre brenda dhe jashtë vendit për llogari të vetë shoqërisë si dhe të tretëve, ku përfshihen inerte, gurë, gurë dekorative, gëlqere, pllaka parafabrikate, llaç, çimento, rërë dhe çdo material tjetër për ndërtim.
- Projektimi dhe zbatimi i veprave ndërtimore si vijon: ndërtime me karakter civil dhe ekonomik, punime/gërmime dhe sistemime dheu, terracime terrenesh, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash, ndërtime urash dhe konstruksione metalike, montime panelesh, ndërtime rrugësh, asfaltime, hapje kanalesh si dhe çdo ndërtim tjetër me karakter civil dhe ekonomik.
- Projektimi dhe zbatimi i veprave ndërtimore rrugë të të gjitha kategorive, punime të mirëmbajtjes dhe të sinjalizimit në rrugë, ndërtim autorstrade-, pista aeroporte dhe helikoptere.
- Projektim dhe zbatim vepra arti, si ura, vepra arti mbi 10 m, ndërtim tunele rrugore dhe hekurudhore, ndërtime detare, ku përfshihen ndërtime portuale, bankina, basen pontile, punime thellimi dhe drenimi, punime për vepra të veçanta e punime speciale, sillose, kulla uji etj.

- Projektimi dhe zbatimi i ndërtimeve hidraulike dhe hidroteknike, ndërtim ujësjellës, kanalizime, kanale e impiante vaditje. Punme mbrojtjeje të sistemit hidraulik, çimentime etj. Ndërtim impiante të trajtimit të ujit, ndërtim diga , galeri, tunele, ndërtim diga të larta etj.
- Zhvillimi dhe ndërmjetësimi i projekteve për rikonstruksionin e ndërmarrjeve industriale. Sigurimi i projekteve industriale ashtu si dhe strukturimi i kontratave afatgjata për levrime dhe mbi bazën e ketij rfinansimi dhe kreditim]. Ndërmjetësimi nxjerrja dhe përpunimi i lëndëve të para të të gjitha llojeve, veprimtari shërbime, etj.
- Kontraktimi me persona fizikë dhe juridike vendas ose të huaj për gjetjen e tregjeve të shitjes për prodhimet dhe punë të shoqërisë.

Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqërisë "ALISSA COSTRUZIONI" Shpk, përbëhet vetëm nga kontributi në lek shqiptare, në shumën prej 100.000 Lekë, e cila është e ndarë në 100 (Njëqind) kuota me të njëjtën madhësi, vlera nominale e të cilave është 1000 (Njëmijë) lekë.

Kuota në përqindje të themeluesit Ortakut të Vetëm të Shoqërisë në kapitalin themeltar është 100 % (njëqind përqind).

Derdhja e kapitalit themeltar është bërë duke derdhur në Lek shumën prej 100.000 lekë, në Degën e Bankës RAIFFEISEN BANK SH. A. , me anë të depozitimit të saj ne llogari bankare.

Ortaku i Vetëm nuk kufizohet në ritjen e kontributit të tij me fitimet që rrjedhin nga veprimtaria e shoqërisë.

Ortaku i Vetëm mund të vendosë për ritjen e kapitalit themeltar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi që përcaktohen në mënyrë të detajuar në Statutin e Shoqërisë dhe sipas vendimit të Ortakut të Vetëm.

Detyrimet e Ortakut të Vetëm kundrejt shoqërisë përballohen vetëm për pjesët e kapitalit të derdhur prej tij.

Neni 6

Fitimi i realizuar nga shoqëria, pasi shlyhet detyrimi ndaj të tretëve, likujdohen taksat përkatëse, zbriten fondet e detyruara, fitimi i realizuar, i kalon ortakut të vetëm.

Fitimi i realizuar nga ortakja e vetme mund të transferohen lirshëm jashtë shtetit, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie, kjo shoqëri përgjigjet vetëm me kapitalin e saj. Ortaku i vetëm nuk mban përgjegjësi për detyrimet e shoqërisë me pasurinë e tij që nuk bën pjesë në kapitalin e kësaj shoqërie.

Neni 7

Shoqëria ka të drejtë të ketë llogari, në lekë dhe në valutë, në banka shqiptare dhe të huaja në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ka të drejtë t-i disponojë lirshëm mjetet monetare të grumbulluara.

Neni 8

Shoqëria "ALISSA COSTRUZIONI" Shpk është pronë e Ortakut të Vetëm, i cili gëzon dhe të gjitha atributet e Asamblesë së Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratori Ligjor i Shoqërisë Z. Albert Dimço. Sipas nevojave që paraqiten për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë ortaku i vetëm emëron e punëson dhe administratorë të tjerë cilët qëndrojnë në detyrë derisa revokohen nga shoqëria ose largohen me dëshirën e tyre. Administratori i emëruar i ka të gjitha kompetentat për të vepruar në emër të shoqërisë me përjashtim të rasteve të veçanta që ligji i jep shprehimisht Ortakut të Vetëm.

Neni 9

Ortaku i Vetëm dhe Administratorët Ligjor të Shoqërisë janë të detyruar që të ruajë sekretin e dokumentacionit dhe të informacionit si dhe eksperiencës së realizuar brenda kontekstit të shoqërisë dhe të evitojnë përhapjen e tyre qoftë dhe pjesërisht. Këta përgjigjen për pasojat e domosdoshme që rrjedhin nga shkelja e detyrimeve të mësipërme, në qoftë se shkelja ka ndodhur për fajin e tyre.

Neni 10

Shoqëria ka stemën dhe vulën e saj. Stema e shoqërisë krijohet me Vendim të Ortakut të Vetëm. Në vule shkruhet : "Republika e Shqipërisë, Shoqëria "ALISSA COSTRUZIONI" Sh.p.k Albania.

Forma e vulës do të caktohet nga Ortaku i Vetëm me Vendim Asambleje. Çdo ndryshim i vulës së shoqërisë bëhet nga Ortaku i Vetëm, me Vendim të veçantë të tij, i cili legalizohet dhe depozitohet në Regjistrin Tregtar.

Çdo shkresë e dokumentuar dhe lëshuar nga përfaqësuesi i kësaj shoqërie, do të jetë e vlefshme vetëm pasi të nënshkruhet nga personi kompetent dhe të vuloset me vulën e shoqërisë.

Neni 11

Nëse Shoqëria do të likuidohet atëhere do të caktohet një komision likuidimi që do të parashtojë një bilanç likuidimi për miratim.

Neni 12

Organi i zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve në rast se nuk do të arrihet në një zgjidhje me mirëkuptim, do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë.

Neni 13

Veprimtaria e Shoqëria do të rregullohet, përveç këtij Akti Themelues edhe me dispozitat e Stasutit të saj, të cilat pasi nënshkruhen nga ortakja e veteme përpara noterit, më pas do të miratohen në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë në ditën e regjistrimit si person juridik në Shqipëri.

Për çeshtje që nuk parashikohen dhe rregullohen nga ky akt Themelimi dhe Statuti përkatës do të vlejnë dispozitat e Ligjit Nr.7638, datë 19. 11. 1992 "Për Shoqëritë Tregtare" seksioni për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore që kanë të bëjnë me funksionimin sa më mirë të shoqërisë, të cilat do të rregullojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë së kësaj shoqërie.


Neni 14

Ky Akt themelimi është hartuar në 5 (pesë) kopje, në gjuhën shqipe, duke patur secila kopje fuqi të njejtë ligjore. Nga këto një kopje mbahet nga noteri, një kopje depozitohet në Zyrën e Regjistrin Tregtar, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, dhe një kopje depozitohet në Zyren e Tatimeve. Kopjet e tjera do të qëndrojnë në selinë e Shoqërisë "ALISSA COSTRUZIONI" si dokument themelitar i shoqërisë.

SHOQËRIA "ALISSA COSTRUZIONI" SHPK

ORTAKU I VETËM

Artan DULAKU



STATUTI I SHOQËRISË
"ALISSA COSTRUZIONI" SHPK



Në bazë të ligjit 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", dhe ligjit 7667 datë 28.1.1993 "Për Regjistrin Tregtar", unë e nënshkuara shpall si më poshtë vijon :

FORMIMI I SHOQËRISË

Nen 1

Formohet Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar e quajtur "ALISSA COSTRUZIONI" SH.P.K., me themelues Ortakun e Vetëm :

Z. Artan DULAKU, i datëlindjes 30. 05. 1965, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në adresën : Rruga "Pjetër Bogdani", Nr. 2414, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i Pasaportës me Nr.Z. 0031648, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

SELIA E SHOQËRISË

Neni 2

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën Rruga e " Perlat Rexhepi", Zyra Nr. 6, në katin II, të Godinës me 2=13 Kate, Tiranë. Shqipëri. Shoqëria ka të drejtë të hapë degë, filiale apo përfaqësi të saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë territorit të Shqipërisë ku ajo ushtron aktivitetin e saj, pas miratimit nga organet kompetente shtetërore.

KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË EKONOMIKE

Neni 3

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pakufizuar mbi 10 (dhjetë) vjet dhe fillon që prej datës së regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë

Ajo mund të përfundojë veprimtarinë e saj përpara këtij afati në rastet e prishjes ose likuidimit të shoqërisë të parashikuara këto sipas Ligjit Nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" ne seksionin e V-te tij.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Neni 4

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është si më poshtë :

- Prodhimi dhe tregëtimi me shumicë dhe pakicë i materialeve të ndërtimit, import eksport i tyre brenda dhe jashtë vendit për llogari të vetë shoqërisë si dhe të tretëve, ku përfshihen inerte, gurë, gurë dekorative, gëlqere, pllaka parafabrikate, llaç, çimento, rërë dhe çdo material tjetër për ndërtim.
- Projektimi dhe zbatimi i veprave ndërtimore si vijon: ndërtime me karakter civil dhe ekonomik, punime/gërmime dhe sistemime dheu, tarracime terrenesh, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash, ndërtime urash dhe konstruksione metalike, montime panelesh, ndërtime rrugësh, asfaltime, hapje kanalesh si dhe çdo ndërtim tjetër me karakter civil dhe ekonomik.

- Projektimi dhe zbatimi i veprave ndërtimore rrugë të të gjitha kategorive, punime të mirëmbajtjes dhe të sinjalizimit në rrugë, ndërtim autorstrade-, pista aeroporte dhe helikoptere.
- Projektim dhe zbatim vepra arti, si ura, vepra arti mbi 10 m, ndërtim tunele rrugore dhe hekurudhore, ndërtime detare, ku përfshihen ndërtime portuale, bankina, basen pontile, punime thellimi dhe drenimi, punime për vepra të veçanta e punime speciale, sillose, kulla uji etj.
- Projektimi dhe zbatimi i ndërtimeve hidraulike dhe hidroteknike, ndërtim ujësjellës, kanalizime, kanale e impiante vaditje. Punime mbrojtjeje të sistemit hidraulik, çimentime etj. Ndërtim impiante të trajtimit të ujit, ndërtim diga, galeeri, tunele, ndërtim diga të larta etj.
- Zhvillimi dhe ndërmjetësimi i projekteve për rikonstrukcionin e ndërmarrjeve industriale. Sigurimi i projekteve industriale është si dhe strukturimi i kontratave afatgjata për levrime dhe mbi bazën e këtij refinancimi dhe kreditimi. Ndërmjetësimi nxjerrja dhe përpunimi i lëndëve të para të të gjitha llojeve, veprimtari shërbime, etj.
- Kontraktimi me persona fizikë dhe juridike vendas ose të huaj për gjetjen e tregjeve të shitjes për prodhimet dhe punë të shoqërisë.

Neni 5

Kjo shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të risë kapitalin sipas vendimeve të Asamblesë së Ortakut të Vetëm të saj. Në këtë rast do të njoftohen organet e tatim taksave për ndryshimet përkatëse të shoqërisë.

Neni 6

Shoqëria tregtare deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmban ky Statut si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar në datën e regjistrimit në Regjistrin Tregtar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë dhe pasi të marrë licensën përkatëse nga organi përkatës tatimor.

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 7

Kapitali themeltar i Shoqërisë "ALISSA COSTRUZIONI" Shpk, përbëhet vetëm nga kontributi në lek shqiptare, në shumën prej 100.000 Lekë, e cila është e ndarë në 100 (Njëqind) kuota me të njëjtën madhësi, vlera nominale e të cilave është 1000 (Njëmijë) lekë.

Kuota në përqindje e themeluesit dhe Ortakut të Vetëm të Shoqërisë në kapitalin themeltar është 100 % (njëqind përqind).

Derdhja e kapitalit themeltar është bërë duke derdhur në Lek shumën prej 100.000 lekë, në Degën e Bankës RAIFFEISEN BANK SH. A. , me anë të depozitimit të saj në llogari bankare.

Neni 8

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë me krijimin e kësaj shoqërie vlerën e kapitalit të derdhur prej tij nuk mund ta tërheqë.

Neni 9

Ortaku i Vetëm nuk kufizohet në pritjen e kontributit të tij me fitimet që rrjedhin nga veprimtaria e shoqërisë. Ortaku i Vetëm mund të vendosë për pritjen, pakësimin apo ndryshimin e kapitalit themeltar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, akteve themelore të krijimit të shoqërisë dhe sipas vendimit të Ortakut të Vetëm, në çdo periudhë që ai e sheh

të nevojshme.

Detyrimet e Ortakut të Vetëm kundrejt shoqërisë përballohen vetëm për pjesët e kapitalit të derdhur nga ai.

TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT THEMELTAR **Neni 10**

Kuotat e kapitalit themeltar të Ortakut të Vetëm janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në raste ndarje pasurore mes bashkëshorteve. Gjithashtu janë lirisht të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve si dhe ndërmjet pasardhësve e paraardhësve të tyre.

Me vullnetin e Ortakut të Vetëm kuotat e kapitalit themeltar mund t'u transferohet edhe personave të tretë, sipas procedurës së përshikuar në ligj.

Në rast vdekjeje të Ortakut të vetëm të shoqërisë, trashëgimtarët e tij mund të vendosin për likuidimin e shumës së kapitalit themeltar ose për vazhdimin e veprimtarisë duke respektuar rregullat e nenit 46 të Ligjit Nr. 7638 datë 19.11.1998 "Për Shoqëritë tregtare."

Transferimi dhe shitja e kuotave duhet të bëhen me akte noteriale dhe një kopje e këtij akti duhet të depozitohet në librin e Ortakëve. Të gjitha transferimet kanë efekt mbi shoqërinë që nga momenti i regjistrimit në librin e Kuotave.

STEMA DHE VULA E SHOQËRISË **Neni 11**

Shoqëria ka stemën dhe vulën e saj. Stema e shoqërisë krijohet me Vendim të Ortakut të Vetëm. Në vulë shkruhet :
Republika e Shqipërisë, Shoqëria "ALISSA CONSTRUZIONI" Sh.p.k Albania.

Forma e vulës do të caktohet nga Ortaku i Vetëm me Vendim Asambleje. Çdo ndryshim i vulës së shoqërisë bëhet nga Ortaku i Vetëm, me Vendim të veçantë të tij i cili legalizohet dhe depozitohet në Regjistrin Tregtar.

Çdo shkresë e dokumentuar dhe lëshuar nga përfaqësuesja e kësaj shoqërie, që të jetë e vlefshme vetëm pasi të nënshkruhet nga personi kompetent dhe të vuloset me vulën e shoqërisë.

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË **Neni 12**

Shoqëria vepron nën regjimin e pronës private dhe merr përsipër vetë të drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtëkontraktore. Ortakët e shoqërisë drejtojnë procesin për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë si dhe për detyrimet që ka shoqëria ndaj të tretëve pa asnjë kufizim.

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

- 1- Asambleja e Ortakëve
- 2- Administratorët

ASAMBLEJA E ORTAKËVE **Neni 13**

Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë. Asambleja e Ortakëve ushtron gjithë kompetencat që Ligji Nr.7638, i ka dhënë asamblesë së shoqërisë.

Në Shoqërinë "ALISSA CONSTRUZIONI" Shpk, Asambleja përbëhet vetëm nga Z. Artan Dulaku, i cili zotëron 100 % të votave. Vendimet e Ortakut të vetëm, kur janë marrë konform ligjit dhe statutit, janë të detyrueshme për

administratorin jo pronar si dhe për punëmarrësit e shoqërisë.

Në rast transferimi të kuotave të ortakut të vetëm në favor të personave të tjerë, Asambleja e ortakëve përbëhet nga të gjithë ortakët që zoterojnë kapitalin themltar të shoqërisë.

TË DREJTAT E ASAMBLESE **Neni 14**

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë ka kompetencat e mëposhtme :

- Ka të drejtë të bëjë ndryshime në statut, dhe akte të tjera të shoqërisë.
- Të emërojë administrator tjetër nëse e sheh të arsyeshme.
- Të emërojë dhe shkarkojë administratën e punonjësve të shoqërisë ;
- Ka të drejtë të miratojë bilançin e shoqërisë dhe të bëjë ndarjen e fitimit.
- Të emërojë ekspertët dhe revizoret kontabël.
- Të informohet në çdo kohë për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me llogaritë dhe dokumentacionin e saj ;
- Të vendosë për kryerjen e kontroll-revizionit financiar të shoqërisë me ekspertë kontabël të caktuar prej tij ;
- Ajo aprovon çdo lloj veprimi financiar që me ligj dhe me marrëveshje lihet në kompetencë të Asamblesë.
- Përcakton shpërblimin për administratorët, ekspertet, revizorët kontabël.
- Bën transferimin e kuotave të të tretët.
- Bën lidhjen e kontratave për dhënie dhe marrje të drejtash ose ekskluzivitet për tregtimin dhe prodhimin e mallrave të shoqërisë si dhe kontrata në lidhje me organet shtetërore për pjesmarrjen në tender, ankande ose aktivitete të tjera të rëndësishme.
- Realizon blerje, shitje si dhe tjetërsim të pasurive të palujtshme të shoqërisë etj.
- Të drejta të tjera që parashikohen në Ligjin Nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë tregtare."

VENDIMET E ASAMBLESE **Neni 15**

Marrja e vendimeve të Ortakut të Vetëm, mbajtja e procesverbaleve dhe të gjitha dokumentat e tjera që kanë të bëjnë me të duhet të bëhen sipas legjislacionit në fuqi për këtë qëllim.

NDRYSHIMET E STATUTIT **Neni 16**

Ndryshimet e Statut dhe Aktit të Themelimit të Shoqëisë "ALISSA CONSTRUZIONI" Shpk, vendosen nga Asambleja e Ortakëve.

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË **Neni 17**

Shoqëria administratohet nga Administratori Ligjor i zgjedhur dhe i emëruar nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë "ALISSA CONSTRUZION" sh.p.k., kundrejt , afatit kohor për ushtrimin e këtij funksioni prej 1 (një) viti, me të drejtë rizgjedhje.

Administratori Ligjor i Shoqërisë "ALISSA CONSTRUZION" sh.p.k. do të jetë :

Z. Albert DIMÇO, , i biri i Ilias dhe i Llambinisë, i datëlindjes 14. 05. 1953, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në adresën : Rruga e "Elbasanit", Godina 2 +12 Kate, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i Pasaportës me Nr. 0060450, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

Pas kalimit të afatit një vjeçar, administratori njofton Ortakun e Vetëm për përfundimin e detyrës së tij dhe ky i fundit duhet që ti kthejë përgjigje atij brenda 15 ditëve nga dita e mbarimit të afatit të funksionit të caktuar. Në qoftë se brenda 20 ditëve nga dita e njoftimit Ortaku i vetëm nuk i kthen përgjigje administratorit jo pronar për vazhdimin ose

jo të punës, ky i fundit e ushtron funksionin e administratorit automatikisht dhe do të quhet i rizgjedhur edhe për një periudhë tjetër 1 vjeçare.

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE

Neni 18

Administratori i Shoqërisë jo pronar ka të drejtë :

- Të përfaqësojë shoqërinë në të gjitha marrëdhëniet e saj juridike dhe administrative brenda kompetencave të përcaktuara nga ortaku i vetëm i shoqërisë dhe nga statuti.
- Të kryejë çdo veprim që e gjykon të arsyeshëm dhe konform ligjit në interes të shoqërisë.
- Të japë urdhëra apo udhëzime personelit dhe punëmarrësve të shoqërisë dhe të vendosë masa disiplinore ndaj tyre në përputhje me kontratat e punës dhe bazuar në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë.
- Administratori mund të japë prokura në kufinj të që i lejon Ortaku i Vetëm i Shoqërisë për kategori të caktuara veprimësh.
- Të angazhojë shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet veprimeve që janë në përputhje me objektin dhe strategjinë e shoqërisë, duke nënshkruar akte, kontrata të ndryshme, për furnizime publike private, apo çdo lloj operacioni bankar për shumën të përcaktuar posaçërisht me Vendim të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë.
- Të pranojë dhe të largojë nga puna brenda shoqërisë punëmarrës sipas ligjeve në fuqi, brenda nevojave dhe planifikimit të burimeve njerëzore të përcaktuar pas konsultimit më parë dhe miratimit nga Ortaku i Vetëm.

Neni 19

Administratori i Shoqërisë jo pronar ka për detyrë :

- Të punojë, të drejtojë e të organizojë në mënyrë të tillë që t'i sigurojë sukses shoqërisë në veprimtarinë e saj ekonomiko-financiare.
- Të zbatojë vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm dhe urdhërat e tij, të dhëna brenda kompetencave të përcaktuara nga statuti i shoqërisë dhe legjislacioni në fuqi.
- T'i paraqesë në mënyrë të rregullt raportin e administrimit, të inventarit fizik dhe kontabël, bilançit dhe të llogarive vjetore, Ortakut të Vetëm brenda gjashtë muajsh pas mbylljes së vitit financiar paraardhës.
- Administratori është i detyruar të mbajë regjistrat e magazinimit të cilat vihen në dispozicion të organeve Tatimore, Zyrës Doganore për të mundësuar kryerjen e kontrolleve prej saj.
- Administratori i shoqërisë është i detyruar të mbajë inventare të rregullta një herë në muaj. Raporti i administrimit, inventari dhe llogaritë vjetore, hartohen nga Administratori.
- Të përgjigjet dhe dëmshpërblejë shoqërinë për humbjet e shkaktuara me faj ose të kryera nga pakujdesia e rëndë gjatë administrimit.
- Të drejtat dhe detyrime të tjera të përcaktuara nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.

MARRËVESHJET E NDALUARA

Neni 20

Administratorit të emëruar nga Ortaku i Vetëm nuk i lejohet të kontrakttojë në çfarëdoq mënyre qoftë, të marrë hua tek shoqëria, të japë pëlqimin në emër të saj për paradhënie si dhe të bëhet dorëzanës apo të garantojë në emër të saj (shoqërisë) angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Kjo masë zbatohet edhe ndaj përfaqësuesve ligjor të Ortakut të Vetëm, ndaj bashkëshortëve, paraardhësve dhe pasardhësve dhe ndaj çdo personi ndërmjetës.

PËRGJEGJËSITË LIGJORE TË ADMINISTRATORËVE

Neni 21

Administratorët janë përgjegjës individualisht ose solidarisht sipas rastit, ndaj shoqërisë ose të tretëve, për shkeljet

ligjore të Statutit apo faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë. Klauzolat e Statutit që kufizojnë kompetencat e administratorëve duhet të respektohen nga të tretët.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve, kur provon se të tretët e dinin se akti i administratorit i kalon kompetencat e tij, apo objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara, që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit, pasojat përkatëse. Rregullat e këtij neni nuk zbatohen për marrëveshjet që bëhen për operacionet e përditshme dhe të kryera në kushte normale.

Ortakja e Vetme ka të drejtë që, përveç padisë civile për shpërblimin e dëmit, të kërkojë edhe ndjekjen penale kundër administratorëve.



SHKARKIMI I ADMINISTRATORËVE

Neni 22

Administratorët shkarkohen me vendim të Ortakut të Vetëm ose nga gjykata.

SHKRESAT DHE NËNSHKRIMI I TYRE

Neni 23

Çdo shkresë apo akt i hartuar nga Administratori për përfaqësimin e shoqërisë përpara organeve shtetërore, administrative, gjyqësore ose të të tretëve, shkresa e lëshuar në emër të shoqërisë, duhet të jetë e nënshkruar nga administratori, dhe e vulosur me vulën e shoqërisë.

Neni 24

Në rast pengesash si semundje, aksidente, udhëtime të administratorit etj, Ortaku i Vetëm ka të drejtë të marrë vetë detyrën e administratorit të shoqërisë ose të zëvendësojë përkohësisht atë me një person tjetër që ai e gjykon të arsyeshëm. Në këtë rast Ortaku i Vetëm duhet të lëshojë një akt përfaqësimi në emër të shoqërisë për personin e deleguar.

MARRËDHËNIET E PUNËS

Neni 25

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria private merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për dëmet që i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT

Neni 26

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhet publike përmbajtja e tyre për të tretët e të gjitha akteve dhe dokumentave që janë përcaktuar si të tilla nga administratorët e kësaj shoqërie.

EKSPERTËT OSE REVIZORËT KONTABËL

Neni 27

Kontrolli mbi veprimtarinë e Administratorit, veprimtarinë e tij si dhe gjithë aktivitetin e shoqërisë i besohet një

eksperti ose revizori kontabël. Ky ekspert do të qëndrojë në detyrë për aq sa përcaktohet me ligj dhe mund të rizgjidhet. Ortaku i Vetëm cakton dhe shpërblimin përkatës kur nuk ka norma të veçanta ligjore.

BILANCI DHE FITIMET

Neni 28

Shoqëria dokumenton aktivitetin e saj financiar në gjuhën shqipe në Bilancin e shoqërisë, viti i veprimtarisë së shoqërisë fillon me 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti. Përfundimisht, viti i parë i veprimtarisë së shoqërisë fillon duke u nisur nga data e regjistrimit të shoqërisë si person juridik në regjistrin Tregtar dhe mbaron me 31 Dhjetor të vitit në vazhdim.

Administratori jo pronar, pasi merr pëlqimin e Ortakut të Vetëm të shoqërisë, cakton një ekspert kontabël të autorizuar i cili përpilon ose auditon bilancin e vitit ushtrimor paraardhës për të ardhurat, fitimet dhe humbjet, të formuluar këto konform ligjit Nr. 7661, datë 19. 11. 1993 "Për Kontabilitetin".

Ekspertët kontabël të Autorizuar janë përgjegjës si ndaj shoqërisë ashtu dhe ndaj të tretëve për pasojat e dëmshme që rrjedhin nga fajet dhe nga nënvleftësimet e tyre në ushtrimin e funksioneve përkatëse .

Me hartimin e raportit përkatës të auditimit, shoqëria zbaton me përpikmëri rekomandimet e ekspertit kontabël të shoqërisë duke veçuar fondet si më sipër dhe paguar detyrimet fiskale.

Është kompetencë e Ortakut të Vetëm të vendosë për të ardhurat që mbeten, për krijimin e fondeve rezervë nga të ardhurat neto si dhe përdorimin e tyre sipas nevojave që ai e gjykon të arsyeshme për llogari të shoqërisë. Shuma e krijuar për çdo vit ushtrimor duhet të jetë sa 1/20 e të ardhurave neto të shoqërisë në një vit ushtrimor. Ortaku i Vetëm për krijimin e fondit rezervë depoziton në bankë shumën përkatese të këtij fondi.

Neni 29

Në rast se kapitali i shoqërisë për shkak të humbjeve të realizuara rezulton më pak se kapitali themeltar, pronarët vendosin brenda 4 muajve mundësinë e prishjes së jashtëzakonshme të shoqërisë.

SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 30

Në çdo kohë për motive të ndryshme shoqëria mund të ndodhet përballë shpërberjes ose falimentimit të saj. Kjo procedurë realizohet me Vendim të Ortakut të Vetëm ose me kërkesën e personave të interesuar, të cilët përcaktohen sipas akteve ligjore përkatëse në fuqi.;

Në rast se shoqëria vendos të shpërndahet për çdo lloj arsye Ortaku i Vetëm përcakton mënyrën e likuidimit, emëron një ose më tepër likuidator dhe përgatit të gjitha dokumentet e nevojshme për c'regjistrimin e saj nga Regjistri Tregtar.

Shpërbërja e Shoqërisë mund të kërkojë nga një ose disa kreditorë të shoqërisë të cilët kërkojnë likuidimin e shoqërisë për faktin se ajo nuk ka përmbushur detyrimin ndaj tyre.

Mbasi bëhet njoftimi i mbylljes së likuidimit dhe kryhen formalitetet e duhura, shoqëria çregjistrohet nga Regjistri Tregtar i Gjykatës .

LIBRAT E SHOQËRISË
Neni 31

Po kështu shoqëria në bazë të ligjit mban librat e mëposhtëm :

- 1) Libri i Ortakëve
- 2) Libri i Mbledhjeve
- 3) Libri i vendimeve të Administratorëve
- 4) Libri i mbledhjeve dhe vendimeve të ekspertëve ose revizorëve kontabël.

Librat e mësipërm duhet të jenë të ruajtura për 10 vjet e çdo faqe duhet të jetë e vulosur.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME
Neni 32

Përsa është shprehur në këtë statut i referohemi Ligjit 7638 dt 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", Statutit dhe rregullores së brendshme të shoqërisë. Çdo ndryshim bëhet në të njëjtën mënyrë siç është nxjerrë ky Statut dhe nuk prek personalitetin juridik të kësaj shoqërie.

Ky statut firmoset rregullisht nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë "Alissa Costruzioni" Shpk .

SHOQËRIA "ALISSA COSTRUZIONI" SHPK

ORTAKU I VETËM

Artan DULAKU

